



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 61
Prishtinë, më 5.4.2017, në orën 9:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Salih Salihu, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Time Kadrijaj, Emilija Rexhepi, Haxhi Shala, Sergjan Popoviq.

Mungoi: Shaip Muja.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.3.2017;
3. Konsultime për projektligjin për mbrojtjen nga zhurma;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja, **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen, sipas rendit të përcaktuar të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës, për këtë mbledhje, u miratua pa ndonjë shtesë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.3.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 27.3.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Konsultimet e Komisionit për projektligjin për mbrojtjen nga zhurma

Kryetarja, Duda Balje, falënderoi për pjesëmarrje të mysafirëve të ftuar, nga BIK-u, MMPH dhe dy deputetët: Labinote Demi dhe Gëzim Kelmendi. Ajo njoftoi se në mbledhjen e fundit plenare me iniciativën e saj është tërhequr pika e rendit të ditës rreth projektligjit në fjalë për konsultime, ndaj pasi që BIK- u ka kërkuar një iniciativë për diskutim ja dha fjalën z. **Fatmir Ilijazit**, përfaqësues i BIK- ut, i cili për fillim u fokusua në nenin 6, pika 2.6 me pyetjen pse komisioni ka fshirë këtë pikë dhe ku qëndron arsyetimi, ngase kjo pikë shumë mirë e ka definuar çështjen duke cekur se ky ligj nuk ka të bëjë me zhurmën si nga zërimi i kabanave, ashtu edhe nga pajisjet elektroakustike (ku bënë pjesë edhe ezani), njëherit potencoi se BIK-u nuk është kundër limitimit me tabelën përkatëse të MMPH- së, por pse fokusohet komisioni tek ezani sipas shpjegimit të cekur më lart, pra të mbetet projektligji përkatësisht neni 6, ashtu si është propozuar nga Qeveria.

Labinote Demi gjithashtu u fokusua në prekjën e ndjenjave të qytetarëve pikërisht me faktin pse preket ezani me fjalën “pajisje elektroakustike” dhe nuk është kundër standardizimeve.

Emilija Rexhepi, në cilësinë e udhëheqëses së grupit punues në komision, potencoi ngritjen e zërit të saj për mbrojtjen e drejtave fetare dhe njëanshmërinë e ligjit që zërimi i kabanave dhe ezani të trajtohen si indikator të zhurmës ngase është jo drejt, ajo arsyetoi pretendimet e përfaqësuesit të BIK se nuk është dashur të hiqet pika 2.6 e nenit 6.

Adem Salihaj elaboroi gjithashtu për ecurinë e ligjit në fjalë në dy mandate në Kuvend si çështje e ndjeshme. Ai potencoi se Akti i cili është në Kuvend në leximin e dytë është plotësisht i harmonizuar me MMPH dhe personalisht ai ka dashur që fjala zhurmë të zëvendësohet me fjalën zëri por nuk ka kaluar në komision, ngase të gjitha vendet e rajonit trajtojnë ashtu zhurmën. Nuk u pajtua me vlerësimin e zyrtarit të BIK-ut se nënkuptohen xhamitë sipas nenit në fjalë, por për këtë tha se duhet të diskutojmë, sa i përket mandatit të kaluar, tha se ky komision ka vizituar Turqinë rreth limiteve të zëritit dhe i është lënë ministrit me akt nënligjor të vendosë, mirëpo ky komision nuk është pajtuar kjo çështje të definohet me akt nënligjor për shkak se është çështje e ndjeshme dhe është kërkuar nga MMPH tabela nr. 8, d.m.th. komisioni ka hequr pikën 2.6 sepse është afuar nga MMPH tabela.

Emilija Rexhepi ndërhyri dhe shtoi se Kosova nuk ka sistemin e digjitalizuar ndaj edhe nuk mund të pranohet sistemi i Turqisë apo i atyre vendeve ku ka digjitalizim dhe nuk mundemi të kufizojmë zërimin.

Gëzim Kelmendi tha se përvoja nga mandati i kaluar na ka mësuar të jemi më të kujdesshëm, së pari heqja e pikës 2.6 nuk ka arsyetim adekuat dhe direkt preket toleranca fetare ngase preket vetëm ezani përmes fjalës “pajisje elektroakustike”, deputetja. **Labinote Demi** pyeti pse p.sh. nuk ka shënuar komisioni fjalinë “përveç ezanit”. Në Turqi, vazhdoi Gëzim Kelmendi, kjo çështje ju është lënë bashkësisë fetare jo parlamentit, pse edhe ne nuk bëjmë këtë, pyeti por edhe konstatoi se nuk kërkon askush polarizim, por vetëm zgjidhje adekuate.

Adem Salihaj ndërhyri dhe tha se atje bashkësia fetare është ministri ose institucion shtetëror, çka te ne nuk është dhe kërkoi qëndrimin parimor të BIK-ut lidhur me këtë çështje. Sipas diskutimeve të deritanishme ai konstatoi se BIK nuk është kundër limiteve por është kundër trajtimit të ezanit si zhurmë.

Gëzim Kelmendi tha se është mirë të fillojë shteti ynë marrëveshjet me BIK- un, por e keqja është se po ftohen duke mos marr parasysh asnjë sugjerim nga ata dhe pyeti pse ky ligj prek ezanin si burim i zhurmës.

Fatmir Ilijazi përsëriti kërkesën të mos preket pika 2.6 e projektit, kurse tabela nuk pengon BIK-un dhe digjitalizimi i ezanit.

Salih Salihu tha se duhet të përafrojmë disi qëndrimet dhe të përmbylim edhe me një takim të mundshëm por fillimisht kryetarja të diskutoi çështjet procedurale me stafin.

Murat Hoxha u pajtua se duhet të harmonizohet ky nen apo pikë me tabelën përkatëse dhe të mbahet edhe një takim, d.m.th. pika 2.6 me mbetur, por duke harmonizuar atë në mënyrë adekuate.

Emilija Rexhepi potencoi që mos të flitet në disa mënyra, por një qëndrim të marrë komisioni dhe arsyetoi punën e saj në grupin punues duke kërkuar nga stafi shënimet përkatëse për të cilat edhe **Adem Salihaj** dha sqarime por edhe stafi premtoi ofrimin e shënimeve sa dhe kur janë mbajtur takimet e grupit punues me data të sakta.

Kryetarja, Duda Balje, potencoi se do të mbajë një konsultim me sekretarin e Kuvendit pastaj të caktohet mbledhja e komisionit.

4.Të ndryshme

Në pikën të ndryshme u caktuan dy grupe punuese:

Për projektligjin për kompleksin Adem Jashari: **Shaip Muja-kryesues, Haxhi Shala, Murat Hoxha dhe Time Kadrijaj** anëtarë.

Për projektligjin e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguri bërthamore: **Salih Salihu-kryesues, Srdjan Popoviq dhe Shaip Muja**, anëtarë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje